

Vizë

Viza është një leje për të hyrë në Norvegji dhe në shtetet tjerë të Schengenit gjatë një periudhe të kufizuar deri më 90 ditë.

Vizë për vizitë mund të merrni në qoftë se dëshironi të vini në Norvegji si turist, për vizitë familjare, për punë zyrtare ose tregtare, për një vizitë studimi ose në lidhje me punë tjetër ku leja e qëndrimit nuk është e nevojshme..

Një vizë për Norvegjinë ose për shtetet tjerë të Schengenit vlen deri më 90 ditë. Zakonisht, viza nuk mund të zgjatet pasi të keni hyrë në zonën e Schengenit. Përrjashtim mund të bëhet vetëm në raste kur pas hyrjes në zonën e Schengenit ndodh diçka e paparaparë dhe viza origjinale vlen për më pak se tre muaj. Megjithatë, koha e plotë e ndejtjes në zonën e Schengenit nuk mund të zgjatë më tepër se 90 ditë gjatë gjashtë muajve të fundit. Viza që merrni nga Norvegjia vlen për gjithë shtetet e Schengenit.

Kush duhet të kërkojë vizë për të vizituar Norvegjinë?

Në përgjithësi, të gjithë kanë nevojë për vizë për të vizituar Norvegjinë. Përrjashtim nga detyrimi i vizës bëhet për shtetasit e vendeve që kanë marrëveshje për lirim nga detyrimi i vizës. Listën e shteteve që nuk kanë detyrimin e vizës mund ta gjeni në Internet, www.udi.no ose mund të kërkonit informacion mbi vizën nga stacioni norvegjez më i afërt për punë të jashtme.

Përrjashtim nga detyrimi i vizës bëhet, ndër tjerë, për:

- Shtetasit nordikë
- Shtetasit e huaj me pasaportë të vlefshme nga shtete që kanë marrëveshje me Norvegjinë për lirim nga viza
- Persona me pasaportë të vlefshëm norvegjez për të huaj
- Persona me dokument udhëtimi norvegjez të vlefshëm për refugjatë
- Persona me leje qëndrimi / leje pune në Norvegji dhe në shtete tjerë të Schengenit

Ku duhet të drejtohem për të kërkuar vizë për Norvegjinë?

Kërkesa për vizë dorëzohet personalisht në stacionin norvegjez më të afërt për punë të jashtme. Shumica e kërkesave shqyrtohet në vend. Në disa raste, kërkesa mund të dërgohet në Norvegji për shqyrtim nga Drejtoria për të Huajt.

Taksë

Çmimi i vizës paguhet në dorëzimin e kërkesës. Për taksën e përditësuar shikoni në www.udi.no/gebyr ose kontaktoni stacionin norvegjez më të afërt për punë të jashtme.

Sa kohë merr shqyrtimi i kërkesës së vizës?

Në qoftë se shqyrtimi i kërkesës Suaj bëhet në stacionin për punë të jashtme, normalisht shkojnë dy javë para se të merrni përgjigje. Koha e shqyrtimit varet nga sasia e punës në secilin stacion jashtë shtetit. Pyetni atje ku e paraqitni kërkesën. Në qoftë se kërkesa dërgohet më tej në Norvegji, në Drejtorinë për të Huajt (UDI), koha e shqyrtimit do të jetë më e gjatë. Informacionin mbi kohën e shqyrtimit e gjeni në www.udi.no/saksbehandlingstider.

Kërkesa për dokumentacion

- Formular kërkesë
- Fotografia duhet të jetë e miratuar për etiketën e vizës. Shikoni kushtet e fotografisë në www.udi.no.
- Pasaportë ose dokument të vlefshëm të udhëtimit
- Ftesë me shkrim nga referenca norvegjeze
- Dokumentim i farefisnisë (në qoftë se personi i referencës është në farefisni)
- Dokumentim i mjeteve të veta për jetesë ose deklaratë garancie nga referenca. Shikoni faqet e internetit të UDIs.
- Nevoja e dokumentimit ndërron nga vendi në vend dhe mund të ndryshojë. Për shtetas të huaj me detyrim vize që përfshihen nga marrëveshja BEE ose nga konventa e EFTA-s vlejnjë rregulla të veçanta.

Në qoftë se miratohet kërkesa Juaj për vizë

Duhet të keni sigurim të vlefshëm për udhëtim dhe shëndet në gjithë shtetet e Schengenit, dhe mbulesa minimale duhet të jetë 30 000 EURO. Dokumentimi i sigurimit duhet të paraqitet në lëshimin e vizës.

Për informacion më të gjërë kontaktoni stacionin norvegjez më të afërt për punë të jashtme. Në qoftë se jeni në Norvegji, mund të kontaktoni policinë ose Drejtorinë për të Huajt (UDI).

Në qoftë se dëshironi të studioni, të punoni ose të mbeteni në Norvegji për të jetuar bashkë me bashkëshortin/en ose me familjen, duhet të kërkonit leje qëndrimi nga Drejtoria për të Huajt. Lexoni më shumë në www.udi.no.

Pyetje të zakonshme

A duhet të kërkoj vizë kur kërkoj leje qëndrimi/leje pune në Norvegji?

Nuk mund të merrni vizë për Norvegjinë dhe shtetet e Schengenit në qoftë se doni të vendoseni në Norvegji. Disa kërkesa mund të marrin një vizë hyrjeje (vizë D) para se kërkesa për qëndrim ose për punë të jetë e miratuar. Kjo vlen për rastin kur keni për qëllim të rrini përherë në Norvegji dhe i plotësoni kushtet për lejen e qëndrimit. Kontaktoni stacionin më të afërt norvegjez për punë të jashtme, ose shikoni faqet e Internetit të UDIs.

Ç'farë kërkesë duhet të bëj në qoftë se dua të marthohem në Norvegji?

Në qoftë se keni për qëllim të marthoheni dhe të rrini në Norvegji mund të kërkonit leje qëndrimi për deri më gjashtë muaj për t'u martuar. Duhet të kërkonit leje qëndrimi pranë stacionit norvegjez për punë të jashtme në vendlindjen Tuaj ose në shtetin ku keni banuar gjashtë muajt e fundit me leje qëndrimi të vlefshme. Në qoftë se doni të vizitoni të dashurin/ën dhe të ktheheni në vendlindje pas vizitës, mund të kërkonit vizë për vizitë për deri më 90 ditë.

Ç'farë duhet të kemë për të marrë një vizë?

Duhet të keni pasaportë të vlefshme për të ardhur në Norvegji. Pasaporta duhet të jetë e vlefshme më së pakti për 90 ditë përmbi kohës që përfshihet nga viza. Duhet të keni të holla të mjaftueshme për të udhëtuar dhe për ndejtjen në Norvegji. Në qoftë se nuk keni mjete të mjaftueshme, mund të Ju ndalin në kufi, edhe pse keni vizë. Në disa raste mjafton një garanci ekonomike për ndejtje dhe për udhëtim kthyes nga ana e personit që do të vizitoni. Formulari i garancisë duhet të plotësohet nga personi që do t'a pranojë vizitën në Norvegji (personi i referencës) dhe duhet të ketë vulën e policisë. Formularin e garancisë mund t'a merrni edhe në stacionin norvegjez për punë të jashtme ose nga faqet e internetit të UDIs. Formulari i garancisë duhet të dorëzohet bashkë me kërkesën për vizë.

Duhet të keni leje legale kthimi në vendlindjen ose në një vend tjetër ku keni leje qëndrimi.

Duhet të keni qëllim lëshimin e Norvegjisë kur afati i vizës skadon. Autoritetet norvegjeze mund t'a refuzojnë kërkesën në qoftë se kanë shkak të dyshojnë që do të rrini në shtet pas periudhës për të cilën keni kërkuar vizën.

Nuk duhet të jeni i regjistruar në sistemin informativ të Schengenit (SIS) si person i padëshirueshëm në ndonjë nga shtetet e Schengenit.

A duhet të hyjë domosdo në shtetin për të cilin kërkoj vizë?

Jo. Pasi t'a keni marrë vizën mund të hyni në cilindo shtet të Schengenit, por në qoftë se keni planifikuar vizitë në një shtet tjetër përpos Norvegjisë për shumicën e kohës, duhet të kërkonit vizë pranë ambasadës së atij vendi.

A më duhen viza tjera për të vizituar shtete tjerë të Schengenit?

Jo. Viza që merrni nga Norvegjia vlen për tërë zonën e Schengenit.

A mund të marrë vizë për më tepër se tre muaj në qoftë se vizitohet më shumë shtete?

Jo. Mund të merrni vizë për 90 ditë ose më pak. Duhet të largoheni nga zona e Schengenit para se t'i dalë afati i vizës Suaj. Moslargimi në skadimin e vizës mund të ketë pasoja për një hyrje në të ardhmen.

A mund të ankohem nëse më refuzohet kërkesa?

Po. Në qoftë se ankoheni kundër një refuzimi të bërë në një stacion për punë të jashtme, ankesa dërgohet për shqyrtim në Drejtorinë për të Huajt. Në qoftë se ankoheni kundër një refuzimi të bërë në Drejtorinë për të Huajt, ankesa do të shqyrtohet nga Gjykata për të Huajt (UNE). Shqyrtimi i ankesës është falas.

A doni njoftime më të hollësishme mbi vizën për Norvegjinë?

Në qoftë se doni të keni njoftime më të gjëra mbi vizën mund të kontaktoni stacionin norvegjez të punëve të jashtme që gjindet më afër Jush. Në qoftë se jeni në Norvegji mund të kontaktoni Shërbimin Informativ për Kërkesa në UDI ([Opplýsingstjenesten i UDI](#)) që jep përgjigje norvegjisht, anglisht dhe në gjuhë tjera, në numrin e telefonit 23 35 16 00, ose në postë elektronike ots@udi.no